



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	Institucioni i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr.Br./No.	<u>602/2020</u>
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg.	<u>23/04/20</u>
Dato/Datum/Date:	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 23 prill 2020

Znj. Arta Rama – Hajrizi, Kryetare  
Gjykata Kushtetuese e Kosovës  
Rr. Perandori Justinian, p.n.  
10000 Prishtinë, Kosovë

**Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje lëndën nr. KO 61/20, sipas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për regjistrimin e kërkesës për paraqitjen e komenteve me Nr. ref. : KK 82/20, të datës 20 prill 2020**

**Qëllimi i këtij Opinionit**

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut në lidhje me çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese, që ka të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve Nr. 238/IV/2020, datë 14.04.2020, Nr. 229/IV/2020, datë 12.14.2020 dhe vendimin Nr. 239/IV/2020, datë 14.04.2020, të Ministrisë së Shëndetësisë (vendimet e kontestuara) dhe shfuqizimin e tyre.

**Çështjet kontestuese**

Sipas pretendimeve në çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese, vendimet e kontestuara janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Aktgjykimin e kësaj Gjykate, në rastin nr. KO 54/20, datë 06 prill 2020, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Paraqitësit e kërkesës pretendojnë se vendimet e kontestuara shkelin Kushtetutën, respektivisht nenin 35 [Liria e Lëvizjes], nenin 43 [Liria e Tubimit] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]. Për më shumë, paraqitësit e kërkesës pretendojnë se Ministria e Shëndetësisë ka tejkaluar autorizimet e përcaktuara me nenet 41 dhe 44 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitése dhe se përmes këtyre vendimeve ka kufizuar të drejtën e lirisë së lëvizjes dhe ka cenuar nenin 55 të Kushtetutës.

**Qëndrimi i Avokatit të Popullit**

Më 20 prill 2020, Gjykata Kushtetuese e ka njoftuar Avokatin e Popullit për regjistrimin e kërkesës KO 61/20 me ç' rast ka kërkuar paraqitjen e komenteve lidhur me meritat e kërkesës deri më datë 23 prill 2020.

Me këtë rast, Avokati i Popullit paraqet qëndrimet e veta, në cilësinë e Mikut të Gjykatës, lidhur me çështjen e ngritur në rastrin KO 61/20.

Pandemia COVID-19 paraqet një sfidë të pa precedent për të drejtat e njeriut në mbarë botën. Kuptohet se rrëthanat e tillë, në një formë apo tjetrën, kanë ndikim në kufizimin e të drejtave të njeriut. Sa i përket kufizimeve të të drejtave të njeriut, në rrëthana të tillë, Avokati i Popullit ka shprehur qëndrimet e tij në Opinionin e datës 27 mars 2020 në lidhje me lëndën KO 54/20, të bashkëngjitur këtu.

Rrethanat e krijuara me virusin COVID-19 dhe rrezikshmërinë që ai paraqet për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, kërkojnë një balancim në mes të të drejtës për jetën, e cila nuk mund të kufizohet apo derogohet në asnjë rrëthanë dhe të drejtave tjera për të cilat Kushtetuta dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lejojnë kufizimet, në rrëthana të caktuara. Avokati i Popullit konsideron se pandemia COVID-19, bie në domenin e përkufizimeve të kërcënimit të shëndetit dhe jetës së qytetarëve dhe se shteti është i obliguar që të ndërmarrë masa në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tyre.

Duke ju referuar *Dokumentit Informativ SG/Inf(2020)11, 7 prill 2020*, të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare, Avokati i Popullit thekson: “*Autoritetet ekzekutive duhet të jenë në gjendje të veprojnë shpejt dhe me eficencë. Kjo mund të kërkojë miratimin e procedurave më të thjeshta vendimmarrëse, si dhe lehtësimin e disa kontrollave dhe balancave. Kjo mund të përfshijë, për aq sa lejon kushtetuta, edhe anashkalimin e ndarjeve standarde të kompetencave mes autoriteteve lokale, rajonale dhe qendrore sa u përket fushave të caktuara specifike dhe të kufizuara për garantimin e një përgjigjeje më të koordinuar ndaj krizës dhe se të drejtat e plota të autoriteteve lokale dhe rajonale do të rivendosen sa më shpejt që ta lejojë situata. Megjithatë, parlamentet duhet të vazhdojnë të kenë pushtetin për të kontrolluar veprimet e ekzekutivit, duke verifikuar në veçanti, në intervalë të arsyeshme kohe, nëse kompetencat e ekzekutivit për gjendjen e emergjencës janë ende të justifikuara, ose duke ndërrhyrë në mënyrë ad hoc për të modifikuar apo amuluar vendimet e ekzekutivit.*”<sup>1</sup>

Avokati i Popullit vëren se Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin KO 54/20, datë 06 prill 2020, ka shqyrta hollësish Ligi nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitése dhe Ligjt nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në kuptimin e kompetencave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe në pikën 325 të Aktgjykit, ka konstatuar se:

“*Në fund, Gjykata po ashtu thekson se Ministria e Shëndetësisë, respektivisht Qeveria, vazhdon të jetë e autorizuar që të nxjerrë vendime me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë, për aq sa është e autorizuar përmes të Ligjt nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitése dhe Ligjt nr. 04/L-125 për Shëndetësi.*”

Për më shumë Gjykata Kushtetuese, në nenin 306 të Aktgjykit, thekson se: “*Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se deri në datën e shfuqizimit të Vendimit të kontestuar, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, në rradhë të parë Kuvendi, duhet të ndërmarrin veprimet, në përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim, që i konsiderojnë si të duhura dhe adekuate për të vazhduar parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 – që në vetvete*

<sup>1</sup> Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, Këshilli i Evropës, Dokument Informativ SG/Inf(2020)11, 2.4 Shpërndarja e kompetencave dhe kontrolli i veprimeve ekzekutive gjatë gjendjes së regjimit të emergjencës

*përbën një interes të lartë të shëndetit publik për të gjithë shtetasit dhe personat që jetojnë në Republikën e Kosovës.”*

Avokati i Popullit duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut thekson se ekziston obligimi pozitiv i shtetit, që të ndërmarrë masa parandaluese në rrethana të situatave emergjente me të cilat vihet në rrezik shëndeti i qytetarëve, si dhe të ndërmarrë masa për trajtimin dhe kontrollin e epidemive, endemive dhe sëmundjeve tjera. Avokati i Popullit në veçanti i referohet Parimeve të Sirakuzës mbi Kufizimet dhe Shmangjet nga Dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike, sipas të cilave shëndeti publik mund të paraqet bazë për kufizimin e të drejtave të caktuara në mënyrë që t'u lejohet shteteve për të ndërmarrë masa gjatë kërcënimeve serioze për shëndetin e popullatës apo pjesëtarëve të popullatës. Këto masa duhet specifisht të orientohen në parandalimin e sëmundjes apo lëndimeve apo ofrimit të kujdesit për të sëmurët dhe të lënduarit dhe se me këtë rast do t'i kushtohet vëmendje e duhur rregullave ndërkombëtare të shëndetit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Në Republikën e Kosovës ekzistojnë autoritetet e përcaktuara me ligj, si Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP), Inspektoratit Sanitar të Kosovës, që janë institucione publike, të cilat kanë kompetenca përkatëse në lëmin e shëndetësisë publike. Të gjitha deklarimet publike të profesionistëve shëndetësorë kanë predispositen e alarmit sa i përket mundësisë së përhapjes së infeksionit nga ata që janë të diagnostikuar me sëmundjen, por po ashtu edhe nga personat asimptomatikë, të cilët nuk e dinë që janë mbartës të infeksionit dhe nuk janë testuar për të pasur pasqyrën e qartë mbi statusin e tyre përkitazi me sëmundjen. Së këndejmi, është evidente se ekziston nevoja për vendosjen e masave në parandalimin dhe luftimin e COVID-19.

Avokati i Popullit vëren se edhe vet Gjykata Kushtetuese në përfundimet e Aktgjykimin KO54/20 (shih § 310) ka vlerësuar se:

*“[...] Gjykata në këtë Aktgjykim sqaroi se nuk është roli i saj që të vlerësoj se a janë adekuatë dhe të duhura masat e ndërmarra nga Qeveria për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19. Për më tepër, Gjykata vë në pah se nevoja për të ndërmarrë masa dhe domosdoshmëria e tyre nuk është kontestuar nga asnjë palë në këtë rast. Përcaktimi i politikave rreth shëndetit publik nuk hyn në kompetencat dhe autorizimet e Gjykatës Kushtetuese. Për çështje të shëndetit publik, edhe vet Gjykata Kushtetuese u referohet dhe bindet institucioneve përkatëse shëndetësore dhe profesionale në nivel shtetëror dhe botëror.”*

Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme të vë theksin në faktin se COVID -19 është shpallur pandemi dhe si e tillë nuk është çështje që i përket vetëm shteteve, por paraqet sfidë globale, në shumë segmente. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit ofron një pasqyrë të qëndrimeve të organizatave, mekanizmave dhe akterëve të ndryshëm nga fusha e të drejtave të njeriut, lidhur me kufizimet e të drejtave dhe lirive gjatë pandemisë COVID-19.

## *Deklarata të Ombudsmanëve/Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut*

### **Deklaratë e Avokatit të Popullit të Shqipërisë**

*“Avokati i Popullit i përshëndet masat për kufizimin e qarkullimit të mjeteve e qytetarëve me qëllim ndalimin e përhapjes së epidemisë nga Corona Virusi, por bën thirrje që qeveria ta administrojë me maturi këtë situatë e të mos e përdorë atë për të abuzuar me të drejtat bazike të njeriut”.*

### **Deklaratë e Ombudsmanit të Bosnjës dhe Hercegovinës**

*“Ombudsmani i Bosnjës dhe Hercegovinës ..... në lidhje me situatën me përhapjen e virusit COVID-19 (Korona), u bëjnë thirrje qytetarëve që të respektojnë në mënyrë rigorozë udhëzimet e dhëna nga autoritetet dhe institucionet kompetente dhe të zvogëlojnë lëvizjen e tyre në minimumin e nevojshëm”.*

### **Deklaratë e Ombudsmanit të Kroacisë**

*“Epidemia e koronavirusit është një problem i shëndetit publik që, si çdo emergjencë me përmasa të ngjashme, është i pandashëm nga të drejtat e njeriut. Për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e të tjerëve, rendi juridik, moralë dhe shëndeti publik, liritë dhe të drejtat mund të kufizohen, por vetëm me ligj dhe në përpjevêtim me natyrën e nevojës për kufizim në secilin rast individual”.*

### **Deklaratë e Institutit Danez për Drejtësi**

*“Gjatë pandemisë COVID-19, qeveria ka për detyrë të zvogëlojë infeksionin midis qytetarëve në Danimarkë dhe të sigurojë të ardhmen ekonomike të vendit. Kjo kërkon vendime dhe kompromise të vështira, dhe si rezultat, liria e qytetarëve është kufizuar ndjeshëm gjatë javëve të fundit. Departamenti i të Drejtave të Njeriut pranon se serioziteti i situatës kërkon që qeveria të marrë masa që nuk do të ishin të ligjshme nën të drejtat e njeriut në rrethana normale”.*

*“Të drejtat e njeriut ofrojnë një kornizë të qartë që mund t'i ndihmojë politikanët të vendosin se cilat masa janë të arsyeshme të merren në situatën aktuale. Të drejtat e njeriut mund të janë një mbështetje kur politikanët duhet të lundrojnë në ekuilibrin delikat midis mbrojtjes së jetës së qytetarëve dhe shëndetit dhe, nga ana tjetër, mbrojtjes së lirisë së qytetarëve dhe nevojave individuale gjatë krizës, ”*

### **Deklaratë e Institutit Gjerman për të Drejtat e Njeriut**

*“Kufizimet duhet të janë të kufizuara në kohë dhe efektiviteti dhe efektet e tyre duhet të monitorohen nga afér në mënyrë që të korrigohen nëse është e nevojshme.”*

### **Letër e Komisionit të Barazisë dhe Drejtave të Njeriut të Britanisë së Madhe për Kryeministrin**

*“Komisioni i Barazisë dhe të Drejtave të Njeriut njeh dhe mbështet rolin parësor të qeverisë në kontekstin aktual: për t'i mbajtur njerëzit të sigurt dhe për të mbrojtur të ardhmen e kombit tonë. Kjo duhet të përfshijë vendime dhe kompromise të vështira, shumë larg sférës normale të qeverisjes së përditshme. Sidoqoftë, veprime të tillë do të janë më efektive kur siguria publike dhe interesat ekonomike janë të ekuilibruar me vlerat tona për një kohë të gjatë të lirisë dhe respektit.”*

*“[...] Për shumë njerëz kufizimet në jetën e përditshme do të janë jashtëzakonisht shqetësuese, por përfundimisht të menaxhueshme. Megjithatë, për të tjerët, pasojet mund të janë të thella. Ne besojmë se është e mundur të mbrohen të drejtat ndërsa shpëtojnë jetë.”*

### **Letër e Komisionit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut të Luksemburgut për Kryeministrin**

*“I gjithë planeti po përballet me një pandemi, e cila i nënshtronhet më shumë se 3 miliardë njerëzve, gati gjysmës së njerëzimit, ndaj kufizimeve të jashtëzakonshme për të frenuar pasojet e kontaminimit. Qindra mijëra njerëz janë prekur tashmë nga Covid-19 dhe ka një numër të tmerrshëm të njerëzve që kanë vdekur. Ky virus nuk bën ndonjë ndryshim sa i përket seksit, moshës, fesë, kombësisë, origjinës, ngjyrës së lëkurës, statusit shoqëror ose ekonomik”*

### **Deklaratë e Komisionit për të Drejtat e Njeiut të Irlandës Veriore**

*“Komisioni për të Drejtat e Njeriut ka lëshuar një deklaratë mbi pandeminë Covid-19. Komisioni ka theksuar rëndësinë që të gjithë të ndjekin këshillat e Qeverisë, Zyrtarit Kryesor të Mjekësisë dhe Agjencisë së Shëndetit Publik, pasi do të shpëtojnë jetë dhe do të mbrojnë kujdesin shëndetësor dhe punëtorët e tjerë të vijës së parë.”*

*“Mbështetja e së drejtës për shëndetin, së bashku me mbrojtjen e anëtarëve më të cenueshëm të komuniteteve tona nga një kërcënim ekzistencial, është një qëllim legitim. Politikat e kërkua të distancimit shoqëror dhe vetë-izolimit që janë prezantuar janë një sfidë për të gjithë ne që ndikojnë në jetën tonë familjare dhe liritë e tubimit dhe lëvizjes. Por në një moment të një rëndësie të tillë, kufizime të ashpra të të drejtave tona themelore janë të nevojshme.”*

### **Deklaratë e Ombudsmanit të Portugalisë**

*“Në këtë moment të jetës sonë kolektive, shumë qytetarë po pyesin veten për kuptimin dhe qëllimin e Gjendjes së Emergjencave, të dekretuar nga Shkëlqesia e Tij Presidenti i Republikës. Pyetjet, të shqoqruara me ndjenjat natyrore të shqetësimit, janë në vetvete më shumë se të justifikuara. Asnjëherë më parë, gjatë pothuajse dyzet e katër viteve që Kushtetuta e Republikës ishte në fuqi, nuk pati nevojë të drejtohej te ky instrument i jashtëzakonshëm i rregullimit të marrëdhënieve shoqërore. Tani ka lindur nevoja.”*

*“Duke pasur parasysh fakteqësinë e tanishme publike, nevoja e domosdoshme që të përbajë përhapjen e sëmundjes Covid-19 dhe kështu të shpëtojë jetë, të drejtat dhe liritë ushtrimi i të cilave është, tani e tutje, i pezulluar përkohësisht ato dhe vetëm ato që Dekreti i Presidenti i Republikës Nr. 14-A / 2020 identifikon. Liria e lëvizjes në të gjithë territorin kombëtar, një liri që ne gjithmonë e ushtrojmë pa asnjë kufizim, kryeson listën. Gjithë kjo, sidoqoftë, arsyetohet nga nevoja për të përmirësuar rrezikun e ngjitjes së sëmundjes, dhe për të lejuar Qeverinë - e cila është përgjegjëse për ekzekutimin e Gjendjes së Emergjencave - të menaxhojë në mënyrë qendrore krizën, me miratimin e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e epidemisë.”*

### **Deklaratë e Komisionit për të Drejtat e Njeiut të Skotlandës**

*“Në thelb, të drejtat e njeriut kanë të bëjnë me njohjen dhe respektimin e dinjitetit dhe vlerës së barabartë të secilës qenie njerëzore. Ligjet për të drejtat e njeriut janë krijuar për të udhëhequr dhe rregulluar veprimet dhe zgjidhjet e shtetit, duke siguruar që këto parime të*

*dinjitetit dhe barazisë të mbështesin gjithçka që ata bëjnë. Në të gjithë botën, ne të gjithë po shohim që qeveritë tona të ndërmarrin hapat e duhur për të mbrojtur një nga të drejtat tona më themelore - të drejtën e jetës - si dhe të drejtën tonë për shëndet.”*

### **Deklaratë e Qendrës Kombëtare për të Drejtat e Njeriut të Sllovakisë**

*“Kur kufizoni të drejtat dhe liritë themelore, duhet t'i kushtohet vëmendje thelbit dhe kuptimit të tyre. Kufizime të tilla mund të zbatohen vetëm për objektivin e vendosur, i cili aktualisht është mbrojtja e shëndetit publik, respektivisht duke shmangur kërcënimin për jetën dhe shëndetin e personave të lidhur shkakërish me një pandemi.”*

### **Deklaratë e Ombudsmanit të Spanjës**

*“Epidemia e shkaktuar nga COVID-19 paraqet një kërcënim të një madhësie të tillë, saqë Qeveria është detyruar të dekretojë gjendjen e alarmit në të gjithë vendin, për një periudhë fillestare prej pesëmbëdhjetë ditësh, përmes Dekretit Mbretëror 463/2020, të 14 Marsit.*

*Avokati i Popullit shpreh besimin e tij se masat që merren janë ato të nevojshme për të kapërcyer epideminë. Uniteti i veprimit në këtë kohë të të gjitha fuqive dhe institucioneve të Shtetit është thelbësor.”*

### **Deklaratë e Institucionit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi në Turqi**

*“Përballë kësaj epidemie që kërcënon të drejtat e njeriut në tërësi, të gjitha shtetet botërore duhet të përmbushin plotësisht përgjegjësitë e tyre. Sidoqoftë, kjo luftë nuk duhet të kufizohet vetëm në veprat e administratave shtetërore, por të gjithë duhet të luftojnë në mënyrë efektive këtë epidemi. Të gjithë duhet së pari të kontribuojnë në mbrojtjen e shëndetit të përgjithshëm duke i dhënë rëndësi higjenës së tyre personale. Duhet mbajtur mend se kjo epidemi është një epidemi e kontrollueshme, ajo duhet të përmbushë përgjegjësitë e saj për ta parandaluar atë, dhe duhet të shmangë shkeljen e të drejtave të vvetes dhe njerëzve të tjera.”*

*“Për më tepër, qytetarët tanë nuk duhet të respektojnë asnjë deklaratë tjetër përveç njësive zyrtare, veçanërisht Ministrisë së Shëndetësisë.”*

### **Qëndrimet e Organizatave Ndërkombëtare dhe Rajonale dhe makanizmave të tyre**

#### **Deklaratë e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës**

*“Qeveritë evropiane po luftojnë kundër përhapjes së pandemisë me masa të forta. Kjo është e nevojshme për t'iu përgjigjur sfidës së pasembullt që po hasim. Në të njëjtën kohë, është e quartë se gjëzimi i të drejtave të njeriut ndikohet nga pandemia dhe masat e marra për ta përballuar atë. E drejta për shëndetin, një gamë e gjerë e të drejtave ekonomike dhe sociale dhe liritë civile dhe politike, janë të gjitha shumë të rëndësishme në kontekstin aktual.”*

#### **Deklaratë e Kryetarit të Komisionit Evropian**

*“Gjatë javëve të kaluara, disa qeveri të BE morën masa urgjente për të adresuar krizën shëndetësore të shkaktuar nga shpërthimi i koronavirusit. Ne jetojmë në kohë të jashtëzakonshme, dhe qeveritë, në parim, duhet të kenë mjetet e nevojshme për të vepruar me shpejtësi dhe efektivitet për të mbrojtur shëndetin publik të qytetarëve tanë.”*

## **Letër e OSBE-së drejtar Komunitetit të OSBE**

*"Mbrotja e jetës së njerëzve është përparësia kryesore. Ne e njohim domosdoshmërinë urgjente të masave parandaluese që tani po zbatohen në shumë vende, të cilat mund të kufizojnë disa të drejta të njeriut dhe liritë themelore për një kohë në mënyrë që të mbrojnë njerëzit nga COVID-19 dhe të prishin zinxhirin e tij të transmetimit. Sidoqoftë, masa të tilla emergjente duhet të jenë proporcionale, të përkohshme dhe në përputhje me shtetin e ligjit dhe angazhimet ndërkombëtare."*

## **Qëndrim i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut**

*"Komisioneri i Lartë i KB për të Drejtat e Njeriut Michelle Bachelet të Premten tha se është thelbësore që qeveritë të prezantojnë masa për të penguar përhapjen e koronavirusit, COVID-19, të ndërmarrin një sërë veprimesh shtesë për të zvogëluar ndikimin potencialisht negativ masa mund të ketë në jetën e njerëzve."*

## **Qëndrimi i Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut**

*"Ndërsa ne e njohim ashpërsinë e krizës aktuale shëndetësore dhe pranojmë se përdorimi i fuqive emergjente lejohet nga ligji ndërkombëtar në përgjigje të kërcënimeve të rëndësishme, ne urgjentisht i kujtojmë Shteteve që çdo përgjigje emergjente ndaj koronavirusit duhet të jetë proporcionale, e nevojshme dhe jo diskriminuese. "*

*"Kufizimet e marra për t'iu përgjigjur virusit duhet të motivohen nga qëllimet e ligjshme të shëndetit publik dhe nuk duhet të përdoren thjesht për të hequr kundërshtimin.*

## **Qëndrimi i Komisionit Ndërkombëtarë të juristëve**

### **Simpoziumi COVID-19**

*"Shumë më tepër shtete i janë drejtar fuqive të brendshme të urgjencës, në shkallë vendi ose në baza rajonale ose lokale. Kompetencat e tilla zakonisht përfshijnë rregulla me dekret, d.m.th., ekzekutivin që marrin përsipër kompetencat e bërges së ligjit që normalisht i përkasin Parlamentit të zgjedhur. Përveç një ndërrimi të tillë të pushtetit, në shumicën e rasteve ata lejojnë gjithashtu devijim nga të drejtat themelore të mbrojtura me kushtetutë ose disa prej tyre."*

## **Qëndrimet e OJQ-ve Ndërkombëtare**

### **Rekomandimet e Human Rights Watch drejtar Qeverive**

*"Qeveritë duhet t'i përgjigjen pandemisë COVID-19 duke i dhënë përparësi të drejtës për shëndet për të gjithë dhe respektimit të të drejtave të njeriut..".*

### **Deklaratë e Amnesty International lidhur me gjendjen emergjente**

*"Në rrethana të jashtëzakonshme për sa i përket një emergjencë shëndetësore publike, shtetet mund të kenë nevojë të ushtrojnë fuqitë e tyre të urgjencës. Nëse situata paraqet një kërcënim për jetën e kombit (për shembull nëse sëmundja është dukshëm e transmetueshme dhe e një serioziteti të mjaftueshëm - veçanërisht sëmundshmëri e lartë - ose ekziston rreziku i zgjerimit të mëtejshëm), atëherë shteti mund të jetë i autorizuar të deklarojë një gjendje emergjente në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare."*

## **Qëndrim i Organizatave Joqeveritare të Bashkimit Evropian lidhur me kufizimet e të drejtave**

**Për një Evropë që kujdeset për të gjithë - gjatë pandemisë COVID-19 dhe më gjerë**

*“Bashkimi Evropian duhet të ndërmarrë veprime:*

*“Sigurohuni që masat kufizuese emergjente të shërbejnë për qëllim të luftimit të pandemisë, janë të kufizuara me kohë dhe janë në përputhje me sundimin e ligjit dhe vlerat themelore të BE-së. Njëkohësisht, dialogu dhe mbështetja për shoqërinë e organizuar civile duhet të mbahet.”*

### **Përfundim**

Avokati i Popullit vlerëson se vendimet e kontestuara, në rrethana normale, do të duhej të ishin objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë nga gjykatat e rregullta. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese, në praktikën e saj gjyqësore, në thelb, veçse ka vendosur që nuk duhet fokusuar vetëm në emërtimin e një akti, por në përbajtjen dhe efektet e tij (KO 54/20, datë 06 prill 2020, §161).

Avokati i Popullit, duke iu referuar Aktgjkimit të Gjykatës Kushtetuese, pikës 325 të Aktgjkimit KO 54/20, datë 06 prill 2020, vlerëson se Ministria e Shëndetësisë me nxjerrjen e vendimeve të kontestuara duket ka vepruar në pajtim me këtë Aktgjkim. Nxjerra e vendimeve të veçanta për zonat e afektuara dhe drejtëpërdrejtë të rrezikuara, ka rezultuar me një situatë të re juridike, e cila dallon nga situaçia kur Qeveria ka nxjerrë *Vendimin nr. 01/15, datë 23.03.2020*, për të cilin Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se është në kundërshtim me Kushtetutën. Sa i përket vendimeve të kontestuara të Ministrisë së Shëndetësisë, Avokati i Popullit konsideron se duhet të vlerësohet vetëm nëse ashpërsia e masave të ndërmarra është proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet, gjithnjë duke marrë parasysh rekomandimet e institucioneve të autorizuara me ligj për vlerësimin e situatës sanitare dhe epidemiologjike në vend.

Në anën tjetër Avokati i Popullit konsideron se Aktgjkimi i Gjykatës Kushtetuese KO 54/20, datë 06 prill 2020, ka mbetur i pazbatuar nga ana e Kuvendit. Duke marrë parasysh se ekziston një situatë emergjencë për shëndetin publik, situatë kjo që asnje shtet apo qeveri nuk mund ta zgjidh pa bashkëpunim ndërinstitucional. Në këto rrethana, Kuvendi do të duhej të veprojë në pajtim me autorizimet e veta Kushtetuese, me Aktgjkimin e Gjykatës Kushtetuese si dhe me qëndrimet e Këshillit të Evropës përkitazi me rrethanat e shkaktuara nga COVID-19, e që janë si në vijim:


*“Duke pasur parasysh zhvillimet e shpejta dhe të paparashikueshme të kësaj krize, mund të lindë nevoja për delegime relativisht të gjera legislative, por ato duhet të formulohen sa më ngushtësisht që të jetë e mundur në këto rrethana, me qëllim që të ulin çfarëdolloj potenciali për abuzime.”<sup>2</sup> si dhe*

*“Nëse parlamenti dëshiron ta autorizojë qeverinë të devijojë nga legjislacione të posaçme kryesore (apo legjislacione të miratuara sipas një procedure tjetër të posaçme), kjo duhet të*

<sup>2</sup> Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, Këshilli i Evropës, Dokument Informativ SG/Inf (2020)11, 7 prill 2020, 2.3. Objekti i kufizuar i legjislacionit të emergjencës; parimi i nevojës

*bëhet me shumicën e kërkuar për miratimin e atij legjislacioni, apo duke ndjekur të njëjtën procedurë të posaçme.”<sup>3</sup>*

Lidhur me kompetencat e Kuvendit, Avokati i Popullit, më datë 16 prill 2020,<sup>4</sup> ka paraqitur qëndrimet e veta pranë Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione e që në fakt janë në linjë më qëndrimet e Këshillit të Evropës për rolin e parlamenteve përkitazi me respektimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19.

  
Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Bashkëngjitje:

1. Opinionin i Avokatit të Popullit, i datës 27 mars 2020 në lidhje me lëndën KO 54/20;
2. Qëndrimet e të organizatave, mekanizmave dhe akterëve të ndryshëm nga fusha e të drejtave të njeriut;
3. Dokument Informativ SG/Inf (2020)11, Këshilli i Evropës, *Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19*, 7 prill 2020

<sup>3</sup> Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, Këshilli i Evropës, Dokument Informativ SG/Inf(2020)11, 7 prill 2020, 2.1 Parimi i ligjshmërisë

<sup>4</sup> <http://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-te-drejtat-e-nj-24824/>